



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

KRYETARI

Nr. 6540 Prot

Vau Dejës, më: 18/11 2022

Lënda: Kërkesë për miratim.

KESHILLIT BASHKIAK

Vau Dejës

Të nderuar,

Po ju dërgojmë për shqyrtim dhe procedim dokumentacionin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar Bashkia Vau Dejës

Bashkëlidhur:

1. Vendimi i kryetarit të bashkisë për ndërrmarjen e nismës për rishikimin e PPV Vau Dejës me procedurë të thjeshtësuar.
2. Nisma e miratuar.
3. Dokumenti I rishikimit të PPV Vau Dejës.
4. Aktin e përputhshmërisë së lëshuar nga AKPT.
5. Deklarata mjedisore nga inxh i licensuar mjedisor.
6. Projektvendimin për miratimin e rishikimit të PPV Vau Dejës.

Faleminderit për bashkepunimin.

KRYETARI
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TE TERRITORIT DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ prot.

Vau Dejes, më ____ . ____ .2022

Projekt – Vendim

Nr. 1 Date :18 /11 / 2022

PËR

“Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjetuar”

Në mbështetje të ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar. të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për “Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar); si dhe në Vendim nr.3 KKT dt 27.04.2018 "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës" . në VKM Nr.686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” si dhe në zbatim të *Vendimit të Kryetarit nr.13 date 06.04.2020.*

Në dokumenta: *Rishikimit i PPV Vau Dejes me procedurë të thjeshtuar* ,Akti i përputhmerise se leshuar nga AKPT date nr. 1444/01 date 20.10.2022, Deklarata mjedisore nga ing. I licensuar mjedisor.

PROPOZOJME

Këshillit Bashkiak Vau Dejes të miratojë **“Projekt – Vendimin të Rishikimit të planit të përgjithshëm vendor me procedurë të thjetuar”** ,

Për zbatimin e kësaj rregullore janë të ngarkuara:

- Drejtoria e Planifikimit të Territorit Dhe Investimeve Publike,
- Drejtoria e Zhvillimit Rural , Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Konsumatorit, “Sektorii Menxhimit të Pyjeve dhe Kullotave”.

Konceptoi: Dorina Lekaj

Miratoi: Ana Shurdha

KRYETARI
MARK BABANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 2272 Prot.

Vau Dejës, me: 06.09.2021

VENDIM

Nr. 13, datë 06.09.2020

"PËR MARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
ME PROCEDURË TË THJESHTUAR"

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 b) dhe nenit 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5, pika 1.3 b), nenit 12 pika 2.a), nenit 13, pika 1 b) dhe c), nenit 20, si dhe nenit 26 pika 2 të ligjit nr.107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", (i ndryshuar); nenit 11, nenit 12 dhe nenit 62 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", (i ndryshuar); VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit" (i ndryshuar); Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim Nr.3, datë 27.04.2018 nga Këshilli Kombëtar i Territorit; Udhëzimit Nr. 1, datë 22.02.2019 "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të PPV me procedurë të thjeshtuar" të AKPT;

VENDOSA:

1. Ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me Procedurë të Thjeshtuar për ato çështje dhe kërkesa të cilat janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore, duke mos cënuar vlerat e tyre; me dokumentin e Strategjisë Territoriale ; me Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM); me vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, si dhe drejtimit kryesore të zhvillimit, të parashikuara në dokumentin e PPV të miratuar
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është materiali i nismës
3. Vendimi për ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e PPV-së duhet të publikohet në RKPT brenda 10 ditëve nga data e miratimit.
4. Ngarkohet Drejtoria E Planifikimit Urban Dhe Investimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETAR



Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2021.09.08
08:57:17 +0200



011. 5545/2 Prot
dt. 02.11.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 1444/02 Prot.

Tiranë më 28.10.2022

Lënda: Dërgohet Akti i Përputhshmërisë për dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau i Dejës

BASHKISË VAU I DEJËS

Adresa: Rruga "Qafa e Gurit", Vau i Dejës

Në përgjigje të shkresës Suaj, Nr. 5545 Prot., datë 17.10.2022, protokolluar pranë Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit me Nr. 1444 Prot., datë 24.10.2022 me lëndë: "Kërkesë për pajisje me akt përputhshmërie në kuadër të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të bashkisë Vau i Dejës", Ju bëjmë me dije, si më poshtë vijon:

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit** ka kryer kontrollin e botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe ka rezultuar se janë botuar nga ana e Bashkisë Vau i Dejës në datë 20.10.2022, dokumentet e plota të Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të kësaj bashkie.

Sa më sipër, AKPT ka lëshuar Aktin e Përputhshmërisë për dokumentet përfundimtare të botuara në RKPT.

Lutemi të gjeni bashkëlidhur:

- Aktin e Përputhshmërisë për dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau i Dejës.

Me respekt,

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Adelina Greca



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 1444/101 Prot.

Tiranë, më 20.10.2022

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTIN E RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA VAU I DEJËS

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 9 dhe pikës 3 të nenit 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, e ndryshuar, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar të Territorit, të Vendimit Nr. 3, datë 27.04.2018 të KKT-së “Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor Bashkia Vau i Dejës”, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit, të dhënave elektronike bazë, shkresës nr. 4070/4 Prot., datë 08.07.2022 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si dhe Raportit të Vlerësimit Teknik, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Vau i Dejës.

ADELINA GRECA



DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJES

NISMA

PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
TË BASHKISË VAU I DEJËS
ME PROCEDURË TË THJESHTUAR

KRYETARI

Mark BABANI

Mark
Babani

Dijitally signed by
Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:14:55 +02'00'





Përmbajtja

1. HYRJA.....	3
<i>BAZA LIGJORE</i>	6
2. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIMIN E PPV-SË.....	7
3. DOKUMENTET APO PJESËT PËRBËRËSE TË TYRE, SUBJEKT RISHIKIMI.....	8
4. EKSPERTET QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS PËR RISHIKIMIN E PPV-SË.....	9
5. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE.....	10
6. PLANI I VEPRIMEVE PËR RISHIKIMIN E PPV	11
7. VENDIMIN PER PEZULLIMIN PËR ATO PJESË TË TERRITORIT SUBJEKT RISHIKIMI	12

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:14:55 +02'00'



1. HYRJA



Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 23 pika 14, të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetqeverisjen vendore", nenit 12 pika 2.a), nenit 13 pika 1.b), 26 pika 2 të ligjit Nr.107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e territorit", i ndryshuar, nenit 11, pika 3, 4, nenit 12 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, VKM Nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit" (i ndryshuar), Planit të Përgjithshëm Vendore të Bashkisë Vau Dejës, miratuar me vendim të KKT Nr.3, datë 27.04.2018, Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", si dhe për interesin publik, Bashkia Vau Dejës kërkon të kryej rishikimin dhe korrektimin e dokumentit të planifikimit duke mos cënuar vlerat natyrore dhe mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore dhe nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale.

Autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është Kryetari i Bashkisë Vau Dejës. Dokumenti i rishikimit të PPV do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me AKPT.

Bashkia Vau i Dejës ndodhet në Shqipërinë veriore. Ajo përbëhet nga 6 Njësi Administrative, respektivisht: Nj.A Bushat, Nj. A Hajmel, Nj. A Vig Mnel , Nj. A Shllak , Nj. A Temal dhe Bashki Qender Bashkia ka një sipërfaqe prej 468 km² km² dhe një popullsi prej 50 130 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë,Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë .

Karakteristikat gjeografike/territoriale

Bashkia shtrihet në një sipërfaqe prej 468 km². Densiteti i popullsisë llogaritet të jetë 35.1 banorë për km² në bazë të të dhënave të Censurit 2011. Njësia administrative e Temalit ka sipërfaqen më të madhe të territorit ndërsa Hajmeli shtrihet në vetëm 31 km², duke përfaqësuar njësinë administrative me sipërfaqe më të vogël të bashkisë. Distancat e qytetit të Vaut të Dejës nga qendrat administrative kryesore të vendit dhe rajonit: • 20 km nga Shkodra • 35 km nga Lezha • 40 km nga Velipoja • 44 km nga Porti i Shëngjinit • 47 km nga Ulqini • 69 km nga Podgorica • 80 km nga Aeroporti Rinasit • 94 km nga Tirana

E veçantë për këtë Bashki është ekzistenca e sipërfaqeve të konsiderueshme ujore ku dominon liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës, një pjesë e konsiderueshme e të cilit gjendet brenda territorit administrativ të Bashkisë; lumi Drin që vazhdon në shtratin e tij të vjetër që nga pengesa e digës së Hidrocentralit si dhe lumi Gjadër që shpëputet nga lumi i parë, rreth 1km në juglindje të qytetit të Vaut të Dejës. Pjesa perëndimore e territorit të bashkisë përfshihet në rajonin e Zadrimës. Rajoni i Zadrimës është një nga rajonet më të njohura të Shqipërisë: fusha e Zadrimës me toka pjellore e prodhimit të lartë bujqësore; Pozicionimi i bashkisë përgjatë rrugës Shkodër Pukë – Kosovë e ka identifikuar Vaun e Dejës si një portë hyrëse në drejtim të Kosovës, duke identifikuar nevojën për të studiuar dhe trajtuar korridorin rrugor kryesor Mjedë Vau-Dejës, si dhe ristrukturimin urban të territoreve të banuara në këtë segment. Territori i bashkisë Vau-Dejës karakterizohet nga burime ujore të konsiderueshme, lumenj, liqene, rezervuare dhe përrenj. Liqeni i Hidrocentralit të Vaut të Dejës përfaqëson sipërfaqen më të madhe ujore. Në territorin e bashkisë kalojnë lumi Drin dhe Gjadër dhe një rezervuar me sipërfaqe 2500 ha ndodhet në Vaun e Dejës.

Digitally signed by
M. Babani
Date: 2022.07.26
11:47:17 CEST



VARIA
VAU I DEJËS

Për shkak të këtyre potencialeve të jashtëzakonshme ujore, Vau-Dejës përfaqëson edhe fashën kombëtare energjetike të vendit tonë. Burimet e shumta ujore të territorit të bashkisë, ngrenë më të madhe edhe rëndësinë e menaxhimit të tyre duke marrë parasysh regjimin e çrregullt të ujit në këtë zonë. Për më tepër, rastet e përmytjeve të dekadës së fundit kërkojnë vëmendje për çështjen e menaxhimit të burimeve ujore.

Karakteristikat historike

Historiku i qytetit me emrin sot Vau-Dejës nis me vendbanimin e vjetër të Danjës, i themeluar rreth vitit 1127. Ekzistenca e trojeve të vjetra të kështjellës dhe kishës së Shën Markut, e cila është ndër më të vjetrat në Ballkan, ende sot mbartin vlera arkeologjike për studime historike. Sipas historianëve në këtë zonë organizohej çdo vit një panair i madh në të cilën merrnin pjesë banorë nga krahina e Zadrimës. Në majën që ndodhet në kodrën e Danjës, i mbiquajtur Mali i Shën Markut, ndodhen edhe rrenoja e një kisha që mban të njëjtin emër. Nga emri i kësaj kalaje mori emrin e gjithë zona. Të dhënat arkeologjike flasin për një vendbanim të zhvilluar mesjetar. Kalaja e Danjës sot Deja ka qenë një qendër e zhvilluar dhe me ndikim të madh në të gjithë zonën e Zadrimës. Në këtë kala është bërë lufta me e madhe me Venedikasit ku është vranë Lekë Zaharia. Ai është varrosur në kishën e Shën Mrisë në Vaun e Dejës e cila është tashmë e rindërtuar. Me vdekjen e Lek Zaharisë kalaja u pushtua nga Venecianët, të cilët më pas u larguan nën presionin ushtarak të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Mbas rënies së kalasë së Dejës një pjesë e mirë e popullsisë emigroi drejt Italisë. Deja (ose Danja) ka qenë qytet mesjetar shqiptar shumë i rëndësishëm me një histori vërtet interesante. Qyteti u ndërtua në shek. XI-XII në pikën ku del Drini nga malësitë. Zotëronte rrugën e karvanëve dhe vilte të ardhura të shumta nga doganat që paguheshin për kalimin e Vaut të Dejës. Nga fillimi i shekullit XIII qëndroi nën sundimin e feudalëve serbë. Këtu u fuqizua familja feudale e Zahariajve. Me formimin e principatës së Balshajve, Deja u bë pjesë e saj. Më 1396, Gjergji II Balsha ia kaloi qytetin Venedikut. Në vitet 1423-1443, Deja kaloi dy herë në dorë të osmanëve për tu çliruar në 1443 pas kryengritjes së përgjithshme antiosmane. Zotërimi i Dejës u bë shkak konflikti midis feudalëve N.Dukagjini dhe L.Zaharia në 1445. Pas vrasjes së këtij të fundit, qyteti iu ridorëzua nga e ëma e tij, Venedikut. Ishte pikërisht kërkesa e Skënderbeut që Venediku t'i dorëzonte Dejën që shkaktoi luftën mes tij dhe Venedikut. Skënderbeu e rrethoi në 1447-1448, por nuk e mori dot. Qyteti qëndroi nën Venedikun deri në 1479, kur e ripushtuan osmanët. Pas kësaj, ai nuk u rimëkëmb më. Sot mund të shihet ende Kalaja e Dejës, brenda së cilës janë gërmadhat e një kisha. Qyteti mesjetar Sarda, sot kalaja e Shurdhahut ndodhet një ishull të liqenit Vau-Dejës. Zona përreth kësaj qendre kulturore është një nga vendet më të rëndësishme arkeologjike dhe historike. Këtu ndodhet vendbanimi i hershëm i Gajtanit (Shpella e Gajtanit), vendbanimi i Jubanit (Shpella e Jubanit), Qyteza e Gajtanit, kalaja e Danjës, kalaja e Dalmacës. Qyteza e Sardës deri në fund të shek. XV ka qenë një qendër e rëndësishme kulturore dhe pikë takimi i tre kulturave kryesore të gjithë trevës së veriut, kulturës së Malësisë, të kulturës së Mirditës dhe të Zadrimës të cilat me karakteristikat e veçanta që i dallojnë nga njëra tjetra u kanë rezistuar kohës dhe rrymave kulturore të huazuara nga pushtues të ndryshëm. Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit (Draft) BASHKIA VAU-DEJËS 15 Për këtë qytezë kanë shkruar shumë studiues të huaj dhe studiues arkeologë shqiptarë, të cilët e kanë vlerësuar si një mbartës të kulturës Ilire. Vetë emri i saj i transformuar në Shurdhah ka origjinë Ilire nga qyteti i Sardis, këtu janë gjetur rrënojat e një kalaje romake të shek

Mark Babani
02.14.55.02.20



8 p.e.s. Sarda ka qenë një stacion pushimi në rrugën e vjetër të Dardanisë. Në vitin 877 ka qenë qendër e krahinës së Polatit që përfshinte malësitë në të anët e Drinit nga Liqeni i Shkodrës deri në Kukës. Sarda dikur një qytezë përbri Drinit, si një gadishull strategjik dhe si një pikë ndërlidhëse me rrugën e vjetër Gjakovë-Shkodër-Ulqin, ishte vendbanim i familjes të madhe feudale të Dukagjinëve ku ata ndërtuan pallatin mbretëror; sot një qytezë e pabanuar e rrethuar me kurorën e bukur të ujit të kristaltë të Drinit, është kthyer në një ishull interesant dhe në një pikë të rëndësishme turistike; çfarë ka mbetur sot: përbëhet nga hyrja kryesore e pallatit dhe një kishë e arkitekturës Romake. Uji i liqenit, malet dhe kodrat përreth me gjelbërimin e tyre, krijojnë një Peizazh me bukuri të rrallë, duke i dhënë këtij ishulli vlera të mëdha ekoturistike. Kur flitet për Shurdhahun si një pikëmbërritje turistike është e pamundur që ta ndash nga liqeni artificial i Vaut të Dejës dhe brigjet e tij piktoreske. Ndërtimi i Liqenit të Vaut të Dejës (sip. 24,7 km²) më 1971, e ka kthyer ishullin e Shurdhahut në një destinacion unik. Liqeni me ujin e tij të pastër krijon mundësi për një udhëtim të veçantë dhe mjaft të këndshëm. Ai ka mbuluar murin rrethues të kalasë së Shurdhahut. Megjithatë, përsëri muret e mbetura të kishave dhe të kalasë janë mjaft domethënëse dhe që bien lehtë në syrin e vizitorit. Liqeni i Vaut të Dejës që rrethon Shurdhahun me ujërat e tij, shtrihet thellë nëpër lugina dhe udhëtimi gjatë brigjeve të tij të ofron pamje piktoreske dhe të veçanta ku ndërthuren uji i liqenit, bimësia përreth dhe kafshë të egra që rriten aty dhe shkëmbinjtë gëlqeror që janë herë të thepisur herë jo. Udhëtimi në liqen mund të fillohet nga diga e H/C të Vaut të Dejës ose nga diga e Rragamit. Gjatë rrugës mund të shihet dhe mësohet për Kalanë e Danjës në të cilën gjendet Kapela e Zonjës së Dejës e ndërtuar nga Gjergj Kastrioti pas një fitoreje mbi ushtrinë venedikase në malin e Shën Markut, në majë të të cilit është kjo kala. Gjithashtu në afërsi të dy qendrave mesjetare shtrihen dhe gjetjet arkeologjike në Koman, të cilat dëshmojnë një zhvillim edhe më të hershëm të territorit. Kultura e Komanit është një kulturë e hershme e Arbërisë, që e vazhdon kulturën ilire, që do të thotë se bartësit e saj, arbit, janë shqiptarë të hershëm, pasardhës të ilirëve. Zbulimet e bëra në Delmace të Komanit i hapën rrugë një rindërtimi arkeologjik dhe historik, duke u bërë një pikë reference për mënyrën e zhvillimit të Ballkanit Perëndimor në shekujt VI-XIII pas Krishtit. Në vitin 1898 u ra në gjurmë të një varreze të madhe, pranë Kalasë së Dalmaces, në fshatin Koman të Pukës. Në vazhdim u zbulua një numër i madh varrezash të ngjashme, rreth 30, të përhapura kryesisht në Shqipërinë e Veriut e në atë të Mesme. Shpërndarja gjeografike, tipologjia, inventari dhe kronologjia e njëjtë e këtyre varrezave i ka shtyrë studiuesit të identifikojnë në to kulturën e hershme mesjetare shqiptare, të quajtur "Kultura e Komanit" (shek. VI-VIII). Në vitet e fundit zbulime të Analiza e thelluar dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese të territorit (Draft) BASHKIA VAU-DEJËS 16 "Kulturës së Komanit" janë bërë edhe në Shqipërinë e Jugut si dhe përtej kufijve shtetërorë, në Mal të Zi, Kosovë, Maqedoni e në Greqi. "Kultura e Komanit", qoftë në trashëgiminë e saj të kulturës së lashtë ilire, qoftë me elementet e reja të periudhës së hershme bizantine e, në fund, me shenjat e qarta të besimit të krishterë, është specifike për hapësirën ku dëshmohen shqiptarët në mesjetë. Fig. 1: Gjetje arkeologjike në Koman Vendbanimi i Komanit (Dalmacia e Vjetër), është një vendbanim shumë i rëndësishëm për historinë e antikitetit të vonë dhe mesjetës së hershme në Shqipëri. Komani si vendbanim, i ka dhënë emrin Kulturës së Komanit, përdorur nga historiografia shqiptare dhe arkeologjia, si përkufizues i hipotezës së kalimit nga ilirët tek arbit. Pothuajse e gjithë shtrirja përkon në territorin shqiptar. Zbulimet tregojnë se bëhet fjalë për një qendër të shtrirë minimumi në 35 ha më një vitalitet ndërtimor dhe dendësi banimi të jashtëzakonshme të paktën përgjatë 1000 vjetëve.

Mark Babani



Komani është konsideruar gjithnjë si vendbanimi mitik i shqiptarëve. Në aspektin historik është një aset arkeologjik shumë i rëndësishëm për Shqipërinë. Nga zbulimet e fundit kuptohet se është një qytetërim i tërë, kjo do të thotë që ka qenë një qytet me kisha, shtëpi e punishte. Duke filluar në Shek. XX, vihet re një spostim i qendrave historike drejt zonave bujqësore dhe infrastrukturës së rrugore dhe hekurudhore. Gradualisht qendra historike si Vau-Dejës humbasin rëndësinë dhe qyteza të reja si Bushati do të thithin flukset kryesore të popullsisë.

BAZA LIGJORE

Bashkia Vau i Dejës kërkon të rishikojë dokumentin e planifikimit për një pjesë të territorit me procedurë të përshpejtuar, sipas përcaktimeve të neneve 11 dhe 12 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar.

- a. Neni 26, pika 2 e Ligjit Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, përcakton:

"Planet ndryshohen edhe kur ka ndarje administrative e territoriale, ndryshime të paparashikuara demografike, sociale e ekonomike, ndryshime të shkaktuara nga kriza sektoriale apo nga forca madhore, si dhe në rastet kur lind nevoja e harmonizimit me dokumente të një niveli më të lartë planifikimi apo me ndryshime të kuadrit ligjor në fushën e mbrojtjes e të menaxhimit të territorit, si dhe për arsye të përafritimit me legjislacionin e Bashkimit European".

- b. Neni 11, pika 3 e VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, përcakton:

"Në disa raste, procesi i rishikimit të dokumentit të planifikimit realizohet duke ndjekur një procedurë të thjeshtuar, e cila ka për qëllim të shkurtojë afatet e procesit të planifikimit, këshillimit e të bashkërendimit, të përjashtojë miratimin e nismës dhe të trajtojë vetëm pjesët e dokumentit të planifikimit, subjekt rishikimi, në varësi të rastit dhe nevojave".

Procedura e thjeshtuar ndiqet kur rishikimi i dokumentit të planifikimit bëhet për një pjesë të territorit dhe përmbushen kriteret e mëposhtme:

- a) Dokumentet e planifikimit ndryshohen për çështje që nuk çënojnë vlerat natyrore e mjedisore, zonat e mbrojtura dhe trashëgiminë historike e kulturore;
- b) Rishikimi nuk shoqërohet me ndryshime të strategjisë territoriale;
- c) sipas pikës 2 të nenit 26 të ligjit.

Referuar nenit 12, pika 1 të VKM Nr. 686/2017, Dokumenti i nismës për hartimin e PPV-së, përmban:

- a) hartimin e dokumentit të Nismës për rishikimin e pjesshëm të dokumentit përkatës të planifikimit, duke specifikuar:

- i. qëllimin dhe nevojën e rishikimit të planit;
- ii. dokumentet apo pjesët përbërëse të tyre, subjekt rishikimi;
- iii. ekspertët që do të përbëjnë grupin e punës për rishikimin e dokumentit;

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
DN: cn=Mark Babani,
o=02.14.55.02.007



U D E J E S

iv. përcaktime për procesin e bashkërendimit, këshillimit dhe takimeve publike duke specifikuar afatet;

v. planin e veprimeve për rishikimin e dokumentit;

vi. sipas rastit, vendimin për pezullimin e zhvillimit për të gjithë, ose një pjesë të territorit subjekt rishikimi, sipas nenit 33 të Ligjit, shoqëruar me hartën përkatëse.

b) këshillimin e projekt dokumentit të nismës me Agjencinë dhe publikun nëpërmjet Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit;

c) botimin e dokumentit përfundimtar të nismës, me reflektimet përkatëse në rast të komenteve, shoqëruar me vendimin e autoritetit përgjegjës për hartimin e dokumentit të planifikimit për ndërmarrjen e nismës.

Procesi i rishikimit të PPV-së do të bazohet në **Ligjin Nr. 107/2014** "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, **VKM Nr. 686, datë 22.11.2017** "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", e ndryshuar, **Udhëzimin Nr.1 datë 06.12.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të AKPT-së** "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin edhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të planeve të përgjithshme vendore me procedurë të thjeshtuar", si dhe legjislacionin sektorial në fuqi.

Po sipas përcaktimeve ligjore, autoriteti përgjegjës për rishikimin e PPV-së është kryetari i Bashkisë. Dokumenti do të hartohet në bashkërendim dhe këshillim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

2. QËLLIMI DHE NEVOJA PËR RISHIKIMIN E PPV-SË

Në mbështetje Vendimit Nr.19, datë 30.03.2018, për "Miratimin e Strategjisë Territoriale, Vizionin Strategjik, objektivat e zhvillimit", të miratuar nga Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, Këshilli Kombëtar i Territorit në mbledhjen e datës 27.04.2018 ka marrë Vendimin Nr.3 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës.

Gjatë kësaj periudhe 4 vjeçare të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, autoriteti përgjegjës i planifikimit pranë bashkisë është hasur me disa vështirësi në rregulloren e planifikimit dhe ka lindur nevoja për ndryshime të cilat përfshijnë:

Ndryshimi i sipërfaqeve të disa njësive strukturore të mëdha të cilat janë parashikuar të zhvillohen me PDV, duke i ndarë këto njësi në sipërfaqe me të vogla.

Korrigjime të lapsuseve apo gabimeve të mundshme si mospërputhja e numrit të kateve me lartësisë në metra sipas përcaktimeve të VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar)

Mark

Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:14:55 +0200



Ndryshim të kufijve të Njësive Strukturore apo kushteve të zhvillimit (nr. katesh, lartësi, KSHT, intensitet ndërtimi, etj.)

Ndryshimi i kufijve Administrativo - territorial të Bashkisë Vau Dejës sipas VKM Nr. 360, datë 29.5.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativë territorialë të njësive të vetëqeverisjes vendore"

Heqja e kushtit të hartimit të dokumentit të Planit të Detajuar Vendor, për ato njësi për të cilat është konstatuar si kusht i panevojshëm

Ndryshime ose shtesa në nene të Rregullores së Planit të Zhvillimit të Territorit për t'a përshtatur me ndryshimet e Rregullores së Planifikimit të Territorit gjatë këtyre 4 viteve zbatimi të Planit.

Ndryshime ose shtesa në llojin e përdimit të territorit dhe llojin e ndërhyrjes së lejuar në to.

Stafi i Drejtorisë së Planifikimit të Territorit pranë bashkisë Vau i Dejës ka analizuar me vemendje planin dhe ka njoftuar kryetarin e Bashkisë për çështjet e evidentuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, të cilat nevojitet të rishikohen dhe i ka propozuar për rishikimin e këtij plani, me qëllim rrijen e shfrytëzimit të hapësirave dhe të rrijes së vjeljes së taksave.

3. DOKUMENTET APO PJESËT PËRBËRËSE TË TYRE, SUBJEKT RISHIKIMI

Mbështetur në nenin 54 të VKM Nr. 686, datë 22.11.2017, i cili përcakton përmbajtjen e dokumenteve të planifikimit, dokumentet të cilat janë subjekt i rishikimit të planit të përgjithshëm vendor të bashkisë Vau Dejës, dhe rishikimin e PPV-së e tij sipas procedurës së thjeshtuar bazuar në nenin 11 të VKM-së Nr. 686, datë 22.11.2017 janë si më poshtë:

1. Rregullorja e planit, përmbajtja e të cilit duhet të jetë në përputhje me nenin 58 të VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit" (i ndryshuar), dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar).

2. Plani i Zhvillimit, ku përshkruhen njësitet me PDV

3. Informacioni gjeohapësinor dhe materiali hartografik i PPV-së subjekt i ndryshimit.

Në kuadër të rishikimit të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Vau Dejës synon të bëjë rishikimet si mëposhtë:

- Korrigjimin e kufijve administrativë e territorial të Bashkisë Vau Dejës në zbatim të VKM Nr. 360, datë 29.05.2019 "Për miratimin e hartës së përditësuar të kufijve administrativo-territorial të njësive të qeverisjes vendore".
- Korrektimin e mospërputhjeve apo lapsuseve, në një situatë ku, gjëndja ekzistuese e territorit ka ndryshuar menjëherë përpara miratimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.
- Saktësimin e lartësisë maksimale në kate dhe në metra për çdo njësi strukturore sipas

Mart
Babani

Digitally signed by
Kate
Date: 2022.09.26
02:14:55 +0200



dokumentit të Rregullores së PPV dhe VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit"(i ndryshuar).

- Saktësimin e koeficienteve apo sipërfaqeve të njësive strukturore.
- Rishikimin e kufirit të disa njësive strukturore ose ndarja e tyre.
- Rishikimi i pjesshëm i zonave subjekt i hartimit të PDV-së, bazuar në pikat e mësipërme ku propozohet të hiqet kushti për hartimin e PDV.

Ndryshime ose shtesa në llojin e mënyrës së shfrytëzimit të territorit dhe llojin e ndërhyrjes së lejuar në to.

Ndryshime ose shtime të llojit e objekteve të percaktuara për ndërhyrje në njësi të percaktuara.

Dokumentacioni i përgatitur në kuadër të procedurës së rishikimit të PPV këshillohet në mënyrë të vazhdueshme me AKPT, nëpërmjet postës zyrtare dhe elektronike, takimeve dhe në çdo rast nëpërmjet Rregjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT).

4. EKSPERTET QË DO TË PËRBËJNË GRUPIN E PUNËS PËR RISHIKIMIN E PPV-SË

Grupi i punës së Bashkisë Vau Dejës për rishikimin e dokumentit të planifikimit udhëhiqet nga Drejtoria E Planifikimit Urban Dhe Investimeve Publike dhe ekspertë të tjerë të cilët kanë aftësi në përdorimin e programeve si AutoCAD dhe GIS.

Përsa i përket organizimit të strukturave të përfshira në procesin e rishikimit të PPV-së, dokument i rishikimit të PPV do të hartohet nga stafi i Bashkisë në bashkërendim dhe bashkëpunim me stafin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

Stafi i Bashkisë, i cili do të angazhohet në rishikimin e dokumentit të PPV, përbëhet nga ekspertë të fushave:

- Të planifikimit të territorit;
- Të informacionit gjeohapësinor;
- Të mjedisit;
- Të fushës juridike, të specializuar në çështje të planifikimit të territorit.

Grupi i punës listohet si më poshtë:

1. Ana Shurdha (Ekspert planifikues)
2. Armand Valaj (Ekspert GIS)
3. Martin Luka (Ing. mjedisi)
4. Dorina Lekaj (Jurist)

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:11:15 +0200



Grupi i punës ka për detyrë, administrimin e kërkesave/ankesave të ardhura gjatë zbatimit të PPV-së, shqyrtimin dhe korigjimin e lapsuseve, mospërputhjeve midis pjesëve të ndryshme të PPV-se dhe hartimin e propozimeve për ndryshime të njësisve të ndryshme strukturore në përputhje me kërkesat dhe interesat e Bashkisë për zhvillim.

5. PËRCAKTIME PËR PROCESIN E BASHKËRENDIMIT, KËSHILLIMIT DHE TAKIMEVE PUBLIKE

Gjatë hartimit të dokumentit të planifikimit është tepër e rëndësishme të sigurohet një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi ndërmjet autoriteteve vendimmarrëse dhe komunitetit, me synim trajtimin e çështjeve dhe pengesave të hasura gjatë periudhës 4-vjeçare të zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor.

Në këtë kuadër, autoriteti përgjegjës i planifikimit pranë Bashkisë parashikon të organizojë 1 seance këshillimi dhe takimi publik me grupet e interesit të cilat bëhen subjekt i ndryshimeve të dokumentit të planit. Grupi i punës për rishikimin e dokumentit të planifikimit, gjithashtu do të konsultojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë Bashkisë. Takimet këshilluese zhvillohen me grupet e interesit dhe eksperte të fushës, si edhe, me forumet këshillimore vendore. Takimet këshillimore kanë në fokus tërheqjen e mendimeve dhe sugjerimeve nga grupet e specializuara ose që preken drejtpërdrejt nga dokumenti i planifikimit.

Sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i ndryshuar, bashkërendimi dhe këshillimi i PPV-së është përgjegjësi e njësisë së qeverisjes vendore dhe parashikohet të kryhet një takim publik me grupet e interesit.

Gjatë procesit të rishikimit të PPV, nga grupi i punës në bashkëpunim me AKPT do të vlerësohet:

- Nevoja për konsultim me Ministrinë e Turizimit dhe Mjedisit (MTM), për detyrimin ose jo të ndjekes së procesit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor.
- Nevoja për bashkërendim me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) për ndryshime që mund të propozohen në zonat e banuara brenda Zonave të Mbrojtura.
- Nevoja për bashkërendim me Institutin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore për ndryshime që mund të jenë në afërsi të monumenteve.
- Nevoja për bashkërendim me Autoritetin Rrugor Shqiptar dhe Hekurudhën Shqiptare për ndërhyrje që mund të jenë në afërsi të rrugëve nacionale dhe rrjetit hekurudhor.
- Nevoja për bashkërendim me institucione të tjera publike, sipas propozimeve të bashkisë.

Grupi i punës do të analizojë dhe rishikojë çdo kërkesë të ardhur pranë bashkisë.

Mark
Digitally signed by
Mark Babani
DN: cn=Mark Babani,
o=Deje, ou=Deje, email=mark.babani@deje.gov.al,
02.14.55 +02'00'

Babani



Rezultatet, komentet dhe propozimet e takimeve publike do të reflektohen dhe do ti bashkëlidhen dokumentit të planifikimit.

6. PLANI I VEPRIMEVE PËR RISHIKIMIN E PPV

Pas ndërmarrjes së nismës për rishikimin e PPV-së do të bëhet njoftimi i palëve të interesuara. Projekt-dokumenti i Nismës dhe Nisma e miratuar nga Kryetari do të botohen në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit (RKPT) dhe sipas mjeteve tradicionale të informimit.

Hapat më kryesorë janë si më poshtë:

- Bashkia do të sigurojë një proces dialogu, bashkëpunimi dhe bashkërendimi, horizontal e vertikal, me çdo autoritet të planifikimit e palë të interesuar, përpara fillimit dhe gjatë procesit dhe gjatë rishikimit të PPV-së.
- Bashkia do të këshillohet me AKPT-në dhe palët e interesuara. Bashkia i vë në dijeni rregullisht të interesuarit për ecurinë e procesit, nëpërmjet botimeve në regjistër;
- Vendimi i Kryetarit të Bashkisë, përgjegjës për marrjen e nismës, botohet në RKPT, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së nismës, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
- Vendimi i Kryetarit për marrjen e nismës bëhet publik edhe në faqen zyrtare të bashkisë.
- Bashkërendimi dhe këshillimi kryhet përmes botimit të dokumenteve në regjistër, informimit të palëve të interesuara dhe publikut nëpërmjet një a më shumë mjeteve tradicionale të informimit dhe përmes organizimit të takimeve publike me ta.

Nr.	Etapat e Hartimit	Përgjegjësi	Muaji 1				Muaji 2			
			1	2	3	4	1	2	3	4
1	HARTIMI I NISMES PER NDRYSHIMET NE PPV									
1.1	Vendimi i Kryetarit për nismën	Kryetari i Bashkisë, Grupi i punës								
1.2	Botimi i vendimit ne WEB/RKPT	Grupi i punës								
2	KRIJIMI I DATABAZES									
2.1	Krijimi i data bazës për ndryshimet e kërkuara	Grupi i punës								
2.2	Analiza për ndryshimet e kërkuara PPV	Grupi i punës								
2.3	Dëgjesa Publike	Grupi i punës								

Babani

Digitally signed by Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:14:55 +02'00'



3	Propozimet për ndryshim										
3.1	Hartimi grafik për ndryshimet e kërkuara	Grupi i punës									
3.2	Korrigjimi i pasaportës dhe rregullores	Grupi i punës									
3.3	Përgatitja e hartave	Grupi i punës									
6	MIRATIMI										
6.1	Dëgjesa publike	Grupi i punës									
6.2	Reflektimi i komenteve dhe rekomandimeve	Grupi i punës									
6.3	Takimi i Forumit të bashkëndimit të Planifikimit në nivel Vendor	AKPT, Grupi i punës									
6.4	Lëshimi i Aktit të Përputhshmërisë për dokumentin e Rishikimit të PPV nga AKPT	AKPT									
6.5	Miratimi në Këshill Bashkiak	Këshilli Bashkiak, Grupi i punës									
6.6	Konfirmimi nga Prefekti	Prefekti, Grupi i punës									
6.7	Botimi në regjistër dhe ëeb	Grupi i punës									
6.8	Miratimi i dokumentacionit në KKT	Këshilli Kombëtar i Territorit, Grupi i punës									
7	ZBATIMI DHE MONITORIMI										
7.1	Zbatimi dhe monitorimi i ndryshimeve në PPV	Grupi i punës									

7. VENDIMIN PËR PEZULLIMIN PËR ATO PJESË TË TERRITORIT SUBJEKT RISHIKIMI

Bashkia me ndërmarrjen e kësaj nisme, parashikon pezullimin e zhvillimit vetëm në ato pjesë të territorit (apo njësi strukturore të saj ku propozohen ndryshime në planin ekzistues deri në përfundim të procesit të rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, bazuar në Neni 33 të ligjit Nr.107/2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar.

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2022 09 26
02:14:55 +0200



Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Investimeve Publike

DREJTOR

Msc. ANA SHURDHA

Ana

Shurdh

a

Digitally signed by Ana
Shurdha
Date: 2022.09.26 11:39:42
+02'00'

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2022.09.26
02:14:55 +02'00'



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT URBAN DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 2272 Prot.

Vau Dejës, me: 06.09.2021

VENDIM

Nr. 13, datë 06.09.2020

**"PËR MARRJEN E NISMËS PËR RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
ME PROCEDURË TË THJESHTUAR"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1 b) dhe nenit 23, pika 14, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 5, pika 1.3 b), nenit 12 pika 2.a), nenit 13, pika 1 b) dhe c), nenit 20, si dhe nenit 26 pika 2 të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", (i ndryshuar); nenit 11, nenit 12 dhe nenit 62 të VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", (i ndryshuar); VKM nr. 408 datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit" (i ndryshuar); Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Shkodër, miratuar me vendim Nr.3, datë 27.04.2018 nga Këshilli Kombëtar i Territorit; Udhëzimit Nr. 1, datë 22.02.2019 "Për hartimin, bashkërendimin, miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumenteve të PPV me procedurë të thjeshtuar" të AKPT;

VENDOSA:

1. Ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e Planit të Përgjithshëm Vendor me Procedurë të Thjeshtuar për ato çështje dhe kërkesa të cilat janë në përputhje dhe nuk bien në kundërshtim me legjislacionin sektorial në fushën e mjedisit, zonave të mbrojtura, trashëgiminë historike e kulturore, duke mos cënuar vlerat e tyre; me dokumentin e Strategjisë Territoriale; me Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM); me vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore, si dhe drejtimet kryesore të zhvillimit, të parashikuara në dokumentin e PPV të miratuar
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është materiali i nismës
3. Vendimi për ndërmarrjen e Nismës për Rishikimin e PPV-së duhet të publikohet në RKPT brenda 10 ditëve nga data e miratimit.
4. Ngarkohet Drejtoria E Planifikimit Urban Dhe Investimeve Publike për zbatimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MARK BABANI

Mark
Babani

Digitally signed by
Mark Babani
Date: 2021.09.08
08:57:17 +0200





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

MIRATOHET

KRYETAR I K.K.T-së

Z. EDI RAMA

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Znj. BELINDA BALLUKU

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Z. Mark Bisha

Miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak

Nr. ____, datë _____.2022

Kryetar i Bashkisë

Z. MARK BABANI

**DOKUMENTI I RISHIKIMIT TË
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR BASHKIA VAU I DEJËS**

Miratuar me Vendim të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. ____ datë ____ 2022

Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike:
Ark. ANA SHURDHA

PËRMBAJTJA

KREU I	3
NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT	3
KREU II	10
NDRYSHIME NË TABELAT E TREGUESVE TË ZHVILLIMIT TË NJËSIVE STRUKTUREORE	10
KREU III	24
NDRYSHIME TË HARTËS SË RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË VAU I DEJËS	24
SHTOJCA I	25
<i>HARTAT ILUSTRUESE E NJËSIVE STRUKTUREORE ME NDRYSHIME</i>	25
SHTOJCA II	27
<i>KOORDINATAT E NJËSIVE STRUKTUREORE QË PËSOJNË NDRYSHIME TË KUFLIJE</i>	27
SHTOJCA III	28
<i>PARAQITJA GRAFIKE E NDRYSHIMEVE NË "HARTËN E RRJETIT RRUGOR TË PROPOZUAR" TË PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË VAU I DEJËS</i>	28
SHTOJCA IV	29
<i>PARAQITJA GRAFIKE E MBIVENDOSJES SË FASHAVE MBROJTËSE/TË REZERVIMIT TË RRUGËVE KOMBËTARE ME PLANIN E PËRGJITHSHËM VENDOR TË BASHKISË VAU I DEJËS DHE LISTA E NJËSIVE STRUKTUREORE PËRKATËSE</i>	29

KREU I

NDRYSHIME NË RREGULLOREN E PLANIT

Në "Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau i Dejës", bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Pas nenit 18 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 18/1 me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 18/1: Rastet për të cilat hartimi i PDV-së nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm

1. *Hartimi i Planit të Detajuar Vendor për njësitë strukturore të përcaktuara si subjekt hartimi i PDV-së, nuk është i detyrueshëm dhe/ose i nevojshëm në rastet e mëposhtme. Në këto raste, projektet mund të vijojnë procedurat për pajisjen me leje zhvillimi/ ndërtimi, apo deklaratë paraprake për kryerjen e punimeve, dhe të tjera të ngjashme, pa pritur hartimin dhe miratimin e PDV-së, por në përputhje me kuadrin ligjor të zhvillimit në fuqi.*
2. *Gjatë hartimit të PDV-së, projektet e miratuara sipas përcaktimeve të këtij neni, duhet të integrohen në PDV.*
3. *Rastet përjashtimore janë të aplikueshme vetëm në territore që nuk janë pjesë e Zonave të Rëndësisë Kombëtare, Brezit të Zhvillimit të Kontrolluar e Zonave me Përparësi Zhvillimin e Turizmit dhe përkufizohen si më poshtë:*
 - a. *Për punime në infrastrukturë, të cilat nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore të PPV-së.*
 - b. *Për punime që kanë si pasojë prishjen e objekteve, në rast se prishja nuk shoqërohet me ndërtim të ri, përveç rasteve të parashikuara në këtë nen.*
 - c. *Për ndërtime të përkohshme.*
 - d. *Për punime që realizojnë mirëmbajtje të jashtëzakonshme të objektit.*
 - e. *Për punime si pasojë e emergjencave civile.*
 - f. *Për punime që përmirësojnë aksesin e ndërtesave e strukturave për personat me aftësi të kufizuara.*
 - g. *Kur kërkohet miratimi i projekteve për objekte dhe infrastrukturë publike, në respektim të parashikimeve të PPV-së. Treguesit e zhvillimit të dhëna për njësinë përkatëse do të jenë kufizuese për pronat subjekt i këtij rasti përjashtimor.*
 - h. *Kur kërkohet të kryhen punime për ndërhyrje që nuk kërkojnë pajisje me leje zhvillimi/ ndërtimi ose realizohen përmes deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve, sipas legjislacionit në fuqi.*
 - i. *Kur kërkohet rikonstruksion, riparim dhe restaurim i një objekti ekzistues, për sa kohë këto punime nuk ndryshojnë treguesit e zhvillimit të njësisë.*



- j. Kur kërkohet rindërimi i një banese të degraduar për ta kthyer atë në kushte të përshtatshme jetese, duke realizuar treguesit si KSHT, lartësia në kate dhe në metra (m), intensiteti i ndërtimit dhe distancat nga kufiri i pronës dhe objektet fqinjë, me vlera më të ulëta apo me të njëjtën vlerë si në gjendjen ekzistuese, ose sipas legjislacionit në fuqi (nëse ka parashikime të tilla).
- k. Kur kërkohet rikonstruksioni i një banese ekzistuese me shtesë vëllimi, anësore apo në lartësi për qëllime që lidhen me banimin, për sa kohë objekti i rikonstruktuar nuk tejkalon treguesit e zhvillimit të njësisë. Në çdo rast, shtesa në lartësi nuk duhet të jetë më shumë se 1 kat dhe objekti të mos kalojë lartësinë 3 kat.
- l. Kur kërkohet zhvillimi i një banese një-familjare, e cila plotëson kushtet si më poshtë:
 - i. Është banesa e parë/ kryesore e banimit.
 - ii. Zhvillimi i tokës për banim me struktura një-familjare, është përdorim i lejuar nga PPV-ja në njësinë ku kërkohet zhvillimi.
 - iii. Lartësia maksimale e kërkesës për zhvillim është 2 kat/ 8m, ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit është jo më shumë se 250 m².
 - iv. Me përjashtim të kushteve të zhvillimit të përcaktuara në pikën “iii”, kërkesa për zhvillim duhet të respektojë treguesit e tjera të zhvillimit, sipas atyre të lejuara për njësinë strukturore të PPV-së.
 - v. Në rast se, treguesit e zhvillimit të njësisë për lartësinë e objektit, sipërfaqen totale të ndërtimit dhe parcelën minimale, janë më të vogla se ato të përcaktuara në gjurmën “iii”, më sipër, atëherë mbizotërojnë dhe zbatohen treguesit e zhvillimit të njësisë strukturore.”

2. Neni 23 i Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, ndryshon si më poshtë:

1. *Strukturat e banimit (kategoria A-Banim, BA-Bujqësi-Banim), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe rindërtimit, me të drejtë shtesë mbi sipërfaqen e përgjithshme të tyre, vetëm një herë.*
2. *Strukturat e banimit mund të rikonstruktohen si dhe rindërtohen duke shtuar mbi parametrat e gjendjes ekzistuese 1 kat ose 30% të sipërfaqes totale pa kaluar lartësinë maksimale 3 kat. Në rast shtese të vëllimit anësor, shtesa duhet të lejohet vetëm nëse plotësohet kushti që toka të mos ketë bonitet të kategorisë I-IV. Në këto raste (shtesa të vëllimit anësor) koeficienti total i shfrytëzimit të parcelës për ndërtim nuk duhet të kalojë 50%.*
3. *Strukturat ekzistuese të funksionit banim të përfshira në brezat buferik/brezat e rezervimit të burimeve ujore, varrezave, infrastrukturave rrugore, monumenteve të natyrës, monumenteve të kulturës, etj, mund t'i nënshtrohen punimeve të rikonstruksionit sipas përcaktimeve të legjislacionit të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në fuqi, pa shtesa volumore anësore apo në lartësi.*
4. *Strukturat ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së dhe të paregjistruara, i nënshtrohen procedurave në fuqi për legalizimin dhe regjistrimin në Kadastër, edhe në rastet kur*



përcaktimet e Planit për përdorimin e tokës dhe treguesit e zhvillimit nuk lejojnë zhvillimin, rihvillimin, ristrukturimin, apo forma të tjera ndërhyrje në territorin ku ato ndodhen.

5. *Rekomandohet transformimi i strukturave ekzistuese: ish reparte ushtarake jashtë funksionit, banesa, struktura apo objekte sot pa funksion në struktura të Shërbimeve – nënkategoria S1-Shërbime Akomodimi dhe Argëtimi dhe/ose EB3-Agroturizëm. Këto struktura mund të pasurohen me struktura ekologjike Ekoturizmi NAR4 si dhe hapësira për kampingje me çadra.*
 6. *Strukturat e shërbimit (S-Shërbime), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe/ose rindërtimit, me të drejtë shtese mbi gjurmën ekzistuese, vetëm në lartësi, vetëm një herë dhe pa kaluar lartësinë maksimale 3K.*
 7. *Strukturat industriale-ekonomike (IE-Industri dhe Ekonomi), ekzistuese në momentin e miratimit të PPV-së, të përfshira në sistemin Bujqësor dhe atë Natyror, mund t'i nënshtrohen rikonstruksionit dhe mirëmbajtjes (në kushtet e emergjencës) pa të drejtë shtese vëllimore. Në vazhdimësi, në bashkëpunim me subjektet private-pronare, bashkia duhet të marrë masat për rivendosjen/ zhvendosjen e tyre në territoret e përcaktuara për përdorim të kategorisë IE_Industri dhe Ekonomi.*
3. Pas nenit 23 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohet neni 23/1 me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 23/1: Rregullat për zhvillimet në sistemet Urban, Bujqësor dhe Natyror

1. *Në njësitë që i përkasin sistemit Urban, Bujqësor dhe Natyror lejohet zhvillimi i aktiviteteve agroturistike dhe ekoturistike, me kusht:*
 - a. *Respektimin e përcaktimeve ligjore në fuqi në fushën e bujqësisë, natyrës, mjedisit, pyjeve e kullotave, zonave të mbrojtura, etj, sipas territorit specifik;*
 - b. *Respektimin e përcaktimeve ligjore sektoriale në fushën e agroturizmit dhe ekoturizmit;*
 - c. *Bashkërendimin dhe marrjen e konfirmimit nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare, sipas legjislacionit në fuqi;*
 - d. *Respektimin e kontekstit natyror/bujqësor dhe ruajtjen e peizazhit rural;*
 - e. *Sigurimin e pajisjes së strukturave të veprimtarisë agro/ekoturistike me infrastrukturën inxhinierike të nevojshme, sipas legjislacionit përkatës;*
 - f. *Mosçënimi i infrastrukturës në funksion të tokës bujqësore (kanale kullues/vaditës, rrugë bujqësore, rezervuar, etj).*
2. *Nëse nuk përcaktohet ndryshe në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse apo nga legjislacionit në fuqi, strukturat agroturistike nuk duket të kalojnë 2 kate me nënçati”.*
3. *Pavarësisht përcaktimeve në pasaportën e njësisë strukturore përkatëse dhe pa rënë në kundërshtim me legjislacionin sektorial, për zhvillimet agroturistike në njësitë që i përkasin sistemit Natyrore duhet të zbatohen edhe kushtet si më poshtë:*



- a. parcela minimale nuk mund të jetë më e vogël se 5.000m²
 - b. KSHT max. 15%
 - c. Intensitet max. 0.3.
 - d. Për njësitë strukturore të cilat shtrihen përgjatë liqenit të Vaut të Dejës, largësia në vijë ajrore nga njëobjekt agroturistik në tjetrën të jetë minimalisht 500m.
4. Riparimi, rinovimi, shtesat dhe përshtatja e strukturave ekzistuese të funksioneve të ndryshme të strukturave në funksion të agroturizmit dhe ekoturizmit është e lejuar me përmbushjen e përcaktimeve të këtij neni dhe në çdo rast, duke respektuar legjislacionin sektorial në fuqi. Strukturat ekzistuese mund të zgjerohen në respektim të pikës 2 të këtij neni.
 5. Pas miratimit të kërkesave për zhvillim/ndërtim agroturizmi/ekoturizmi në këto territore duhet të njoftohen zyrtarisht Ministria e Linjës për zhvillimet në fjalë.
 6. Nuk lejohet ndryshimi i destinacionit të strukturave të agroturizmit dhe ekoturizmit në vijimësi.
4. Në nenin 38 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor, shfuqizohet fraza “Varreza 300m”.
 5. Pas nenit 38 të Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor shtohen nenet 38/1 dhe 38/2 me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 38/1 – Vija Blu

1. “Vija blu”, sipas përcaktimeve të VKM Nr. 686/2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” është vija kufizuese e zhvillimit me funksion mbrojtjen e të gjitha burimeve ujore.
2. “Brigjet”, sipas nenit 4, pika 8 të Ligjit 111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, janë rripat anësorë të tokës përgjatë deteve, liqeneve, rezervuarëve, lagunave dhe pellgjeve, si dhe përgjatë rrjedhës së shtratit të lumenjve e përrenjve.
